

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**

**FAKULTETI JURIDIK**



**Tema:**

**Të drejtat fqinjësore si kufizuese të pronësisë – vështrim krahasues**

Mentori/ja:

Prof.Ass. Qerkin BERISHA

Kandidatja:

Sara FAZLIU

## **Abstrakt**

Ky punim synon të prezantojë të drejtat fqinjësore si rregullator për kufizimin e së drejtës pronësore. E drejta e pronësisë në bazë të ligjit është e drejtë absolute, e megjithatë ekzistojnë kufizime të caktuara ndaj kësaj të drejte. Këto kufizime ligjore të pronësisë quhen të drejta fqinjësore. Rrjedhimisht, edhe pse është e drejtë absolute, e Drejta Pronësore prapë se prapë në disa raste i nënshtrohet kufizimeve të caktuara.

Si hipotezë kryesore e temës do të jetë nocioni dhe kuptimi i të drejtave fqinjësore si kufizues i të drejtave të pronësisë, mënyra e kufizimit të së drejtës së pronësisë nga e drejta fqinjësore, në veçanti rastet e kufizimit të së drejtës së pronësisë. Në kuptim të kësaj, me radhë shqyrtohen rastet e kufizimeve nga e drejta absolute e pronësisë, duke përfshirë rastet e imisioneve (imissio), ndërtimit përtej vijës së kufirit, kalimi i domosdoshëm, rrjedha e ujit, degët dhe rrënjët dhe raste tjera që parashihen në sistemin juridik të Kosovës, por edhe nga perspektiva krahasuese.

Përpos trajtimit të të drejtave fqinjësore në Republikën e Kosovës, do të trajtohen edhe sisteme të huaja nga shtetet Evropiane.